




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Nr.

111/01-17793/21

Datë, 28.06.2021

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për Regjistrimin e Nxënësve në Klasën e Dhjetë (10) në Gjinnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor **2021/2022**

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjinnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor **2021/22**, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikata e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor **2021/2022**, bëhet më datën **28, 29 dhe 30 qershor 2021**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **01.07.2021**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **02 korrik 2021**. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriterë:

- | | | |
|--|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

4. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze është, që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).
5. Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.
- Shih: Njoftimin e datës 25.06.2021, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2021-2022

SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" – Kaçanik

Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.	Vitet e shkollimit
Makineri	• Instalues i ngrohjes, klimatizim dhe ujësjellës	2	48	2+1
	• Trafik rrugorë	1	24	2+1
	• Automekanik	1	24	2+1
	• Metalpunues	1	24	2+1
Eklektroteknikë	• Elektroteknikë industriale	1	24	2+1
	• Informatikë	1	24	2+1
	• Instalues elektrik	1	24	2+1
	• Kontabilitet dhe tatime	1	24	2+1
Ekonomi	• Tregti me shumicë dhe pakicë	1	24	2+1
	• Administratë dhe shërbime te zyrës	1	24	2+1
		11	264 nxënës	
Gjithsej				

Gjimnazi “Skënderbeu” - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve të planifikuar
1.	Shkenca Natyrore	4	128 nxënës
2.	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	5	160 nxënës
Gjithsej		9	288 nxënës

Drejtori i DAK
Z. Zahir Doda

